

## Mëso ta përdorësh paranë! Është e ardhmja jote.

Zgjidhni të ndiqni modulën me zgjedhje të lirë "Financat personale në duart tuaja". Njohuritë e përfituara prej tij do t'ju vijin në ndihmë:

- në jetën tuaj si konsumator,
- në marrëdhëniet tuaja të ardhshme me bankat dhe institucionet financiare,
- në karrierën universitare,
- në aftësitë sipërmarrëse,
- në administrimin e mirë të të ardhurave,
- në përmbushjen e objektivave tuaj afatgjatë,
- në planifikimin e suksesshëm të financave tuaja.




[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

BANKA E SHQIPËRISË

Sheshi "Avni Rustemi", Nr. 24, Tiranë, Shqipëri  
Tel.: + 355 4 2419301/2/3;  
+ 355 4 2419409/10/11  
Faks: + 355 4 2419408  
E-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

Tirazhi: 8.000 kopje  
Shtypur në shtypshkronjën AdelPRINT

Design: BRANDa



Financat  
personale  
në **Duarta**  
tuaja

## Paratë nuk rriten nëpër pemë!

Sa herë e kemi dëgjuar këtë frazë nga prindërit tanë ndoshta pa i kushtuar shumë vëmendje. Gjithmonë kemi menduar se prindërit kanë një pemë të artë ku mjafton të zgjasësh dorën dhe të marrësh paratë e nevojshme për të blerë atletet që kemi parë në vitrinën e një dyqani apo celularin e fundit në treg. Por, duke u rritur, kemi filluar të kuptojmë se paratë fitohen me vështirësi dhe për këtë duhen administruar me kujdes.



## Një lëndë e re për edukimin financiar

Moduli me zgjedhje të lirë “Financat personale në duart tuaja” ju ndihmon të kuptoni si mund t’i administroni më mirë paratë tuaja.

Në përfundim të kësaj lënde, ju do të jeni të aftë:

- të hartoni një buxhet të thjeshtë personal dhe familjar,
- të njihni produktet dhe shërbimet kryesore bankare,
- të llogarisni interesat e përfituara nga mbajtja e parave në një llogari rrjedhëse apo kursimi,
- të vlerësoni efektet e inflacionit dhe të kursit të këmbimit mbi vlerën e parasë,
- të përcaktoni mënyrat e ndryshme të kursimit dhe të investimit,
- të dalloni llojet e taksave, sigurimeve dhe fondeve të pensionit.



## Edukimi financiar një investim për të ardhmen

Në kohët e sotme, nevojitet të kesh informacion nga një shumëllojshmëri fushash, për të qenë i suksesshëm në të ardhmen. Ndër to, një vend të veçantë zë edhe edukata financiare.

Lënda e edukimit financiar ju njeh me botën e financave personale. Ajo ju informon dhe formon tek ju aftësitë e nevojshme për të administruar në mënyrë sa më fitimprurëse paratë tuaja. Njohja e përfitimeve dhe e rreziqeve që shoqërojnë produktet financiare, ju aftëson të bëni zgjedhjet e duhura, në momentin e duhur, për të ndërtuar një të ardhme të suksesshme.

